



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 30.10.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Shkumbin Demaliaj dhe Frashër Krasniqi.

Mungoi: Igor Simiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Pajaziti, Kosova Press; Kujtesa Bajrami, RTV 21; Etrur Maloku, Ambasada Amerikane; Shaban Murturi, Edita Kusari dhe Blerta Bejtullahu, EUSR/EUO; Arbesa Shefkiu, BIRN; Erblina Ajazi, Kuvendi; Leorentë Alija, KDI; Sanije Berisha, OSBE; Fisnik Galani, Handikos; Gëzim Zejnullahu, AKNUP; Agim Maraj, British Embassy; Pranvera Reçica, ISSP ; Rreze Hoxha, GLPS; Aferdita Smajli-Kalaja, EU Office; Erblina Sejdiu, praktikante dhe Frashër Rracaj, kryetari Sindikatës së Shërbimit Korrektues.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-110 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;

3. Diskutim në lidhje me vërejtjet e Sindikatës së Pavarur të Shërbimit Korrektues të Kosovës për Projektligjin për Pagat;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të pa paguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete;
5. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-110 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kryetarja paraqiti në shqyrtim në parim projektligjin nr. 06/L-110 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës duke thënë se ligji në atë ka pasur pengesa për të kaluar dhe është kundërshtuar nga opozita për faktin se rrjedh nga një marrëveshje që ka pasur për qëllim njohjen e kopjeve të regjistrave kadastralë, mirëpo tani ka ardhur ndryshim plotësimi i tij. Po ashtu tha se nuk e përkrah këtë projektligj, për faktin se është e pa pranueshme se si Kosova nuk i ka regjistrat origjinalë kadastralë d.m.th. një shtet sovran është e pa pranueshme të veprojë me kopje ngase ato i ka vjedhur Serbia nga Kosova dhe ato duhet të jenë në Republikën e Kosovës. Më tej kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Hajdar Beqa tha se në këtë fazë ne e përkrahim dhe pajtohet me znj. Haxhiu që duhet t'i jenë regjistrat origjinal dhe jo kopjet e fletave poseduese. Propozoi që grupi i punës që do të formohet për këtë projektligj të jetë gjithëpërfshirës për këtë projektligj, por kërkoi nga anëtarët e komisionit që ta përkrahin në parim. Në fund tha se duhet përgëzuar ministria për këto ndryshim plotësime, por të njëjtën kohë mund të bëhen ndryshimet plotësimet, që janë të nevojshme dhe të domosdoshme.

Korab Sejdiu tha se duhet të kemi kujdes kur të trajtohet ky projektligj në grup të punës për këto dy nene, neni 7, nënparagrafi 6.1 dhe neni 13, nënparagrafi 3, sepse nëse e kalojmë ashtu siç është trajtuar me anë të këtij projektligji ekziston si e hapur mundësia e keqpërdorimeve eventuale. Pra, kjo çështje a duhet lënë në duart e sekretariatit që një pjesë të madhe t'i adresojnë ata apo të ngarkohet komisioni dhe t'i lihet komisionit dhe ata të merren me lëndët.

Shkumbin Demaliaj tha se duhet të përkrahët ky projektligj duke thënë se regjistrat kadastralë nuk i ka marrë Serbia, por administrata e Millosheviqit. Më tej tha se mund të diskutohen këto çështje gjatë shqyrtimit në grupe të punës dhe të rregullohen këto çështje në mënyrë që të ecim përpara sepse nëse nuk e bëjmë ligjin e dytë, ligji i parë është në fuqi.

Kryetarja tha se nuk mund të rregullohet ky projektligj me grupe të punës sepse pranimi i kopjeve të regjistrave kadastralë është rregulluar me marrëveshjen që e ka nënshkruar Edita Tahiri. Prandaj nuk ka mundësi që ky gabim të rregullohet me formimin e grupeve të punës duke pohuar se nuk

ka dallim mes Serbisë së djeshme me Serbinë e sotme, përveçse në të kaluar ka kryer gjenocid dhe krime lufte, ndërsa sot kryen në forma të tjera. Gabimi ka qenë që në fillim ku nuk kanë vendosur kushte ndaj Serbisë për të pagjeturit, dëmshtëpërblimet, kërkim faljen, kthimin e regjistrave kadastralë origjinal, arte faktet kulturore, pensionet etj. Tha se nuk mund të bëhem pjesë e marrëveshjeve të cilat janë goditje shumë dimensionale ndaj Republikës së Kosovës dhe kjo është arsyeja, që nuk mund ta legjitimojmë atë gabim, që e ka bërë Qeveria e kaluar.

Hajdar Beqa tha se ky plotësim ndryshim e avancon kuadrin ligjor në raport me ligjin aktual që është në fuqi dhe nëse ne nuk e bëjmë këtë hap sot edhe në grup të punës ne mbesim mbrapa dhe nuk bëjmë asnjë zhvillim. Po ashtu tha se nuk është në rend dite shqyrtimi i marrëveshjeve që i ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës me Qeverinë e Republikës së Serbisë duke pohuar se fushëveprim i Komisionit është që të gjitha projektligjet të cilat procedohen për Kuvend duhet të jenë në pajtim me ligjin e zbatueshëm dhe Kushtetutën. Më tej tha se nëse ka vullnet politik të punojmë në grup të punës dhe të garantojmë që kemi për të qenë të gjithë në dispozicion që ky ligj ka për të qenë shumë i mirë në interes të infrastrukturës ligjore, por edhe të qytetarëve.

Bilal Sherifi tha se natyrisht që detyra jonë është të rregullojmë diçka, por nuk mund ta lëmë pa nënvizuar se Marrëveshja ka qenë e gabuar dhe e ka sjellë këtë dëm. Pra, nuk mund të thuhet më nga aktorët që i kanë lidhur këto marrëveshje se janë të këqija, ndonëse i kanë lidhur vetë ato marrëveshje. Pikërisht për faktin se jemi në një proces të dialogut me Serbinë dhe në një debat të brendshëm për të filluar dialogun me Serbinë është mirë t'i shohim gabimet që i kemi bërë në të kaluarën dhe të mos gabojmë të ardhmen.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni me 4 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet Projektligji nr. 06/L-110 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

3. Diskutim në lidhje me vërejtjet e Sindikatës së Pavarur të Shërbimit Korrektues të Kosovës për Projektligjin për Pagat

Kryetarja paraqiti për diskutim vërejtjet e Sindikatës së Pavarur të Shërbimit Korrektues për projektligjin për Pagat dhe ftoi z. Frashër Rracaj të shpreh shqetësimet e Shërbimit Korrektues rreth Projektligjit për Pagat.

Frashër Rracaj tha se vërejtje e shërbimit korrektues të Kosovës për projektligjin për pagat është se nuk figurojmë fare në pasqyrën pagave, as në kategori dhe as në koeficient. Po ashtu mungon ligji për shërbimin e burgjeve dhe mungesa e këtij ligji sjell pasoja të mëdha për shërbimin korrektues dhe sidomos për stafin e uniformuar, që punojnë në shërbimin korrektues. Vërejtjet janë dërguar edhe me shkrim, ndaj kërkojnë që të kenë mbështetje, që të futet si kategori e

barabartë me policinë, pra ashtu si trajtohet policia me këtë ligj ashtu të trajtohen edhe shërbimi korrektues si staf i uniformuar.

Kryetarja tha se është bërë padrejtësi ndaj jush vazhdimisht edhe në paga, por edhe në benifite të tjera. Znj. Haxhiu theksoi se Komisioni për Legjislacion nuk është direkt i lidhur si Komision Funkcional për projektligjin për pagat, por i kemi marrë vërejtjet te institucione që bien në fushëveprim të Komisionit dhe ia kemi adresuar Komisionit për Administratë. Po ashtu janë caktuar dy anëtarë të Komisionit; z. Sami Kurteshi dhe z. Shkumbin Demaliaj për të marrë pjesë në grupin e punës të Komisionit për Administratë kur të diskutohet për projektligjin për pagat. Në fund tha se vërejtjet tuaja janë të drejta, prandaj do t'i adresojmë si të tilla.

Bilall Sherifi tha se kjo është kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë dhe mbase është dashur që këto vërejtje t'i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë.

Frashër Rracaj tha se vërejtjet tona i janë dorëzuar disa vite Ministrisë së Drejtësisë, mirëpo në mungesë të bazës ligjore nuk kanë arritur të bëjnë asgjë, pavarësisht se ka pasur tentativë nga ministri sepse nuk figurojmë fare në pasqyra për paga. Më tej z. Rracaj tha se është dashur të gjejmë një mënyrë, që të futemi në listën për paga.

Kryetarja tha se ka pasur rastin disa herë edhe zyrtarisht, që t'i vizitoj burgjet dhe t'i takojë edhe shërbimin korrektues duke i njohur kushtet, si të punës edhe të pagës të cilat janë të mjerueshme, prandaj e shohim të rëndësishme, që t'ju mbështesim në këtë drejtim. Po ashtu tha se kjo mbështetje është dashur që të vijë edhe nga Ministria e Drejtësisë ngase është përgjegjëse direkte për burgjet.

Hajdar Beqa pyet se a keni marrë përgjigje nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me këto vërejtje që i keni dërguar? Po ashtu tha se në lidhje për këtë çështje ne si komision ju përkrahim.

Frashër Rracaj tha se ministri ka bërë tentativë gjatë gjithë kohës dhe se ka vullnet për të na mbështetur, por mungesa e ligjit e ka pamundësuar. Në fund theksoi se të tejkalohej kjo çështje do duhej që të hartohet projektligji për burgje.

Kryetarja tha se shumë shpejt do të ftojme edhe drejtorin e përgjithshëm të burgjeve, në mënyrë që diskutojmë për këto shqetësime dhe probleme. Ndërsa sa i përket njoftimit vendimin për qendrën e paraburgimit në Pejë, pas takimit që kemi pasur me ju, ne, si komision, i jemi drejtuar me shkrim ministrit dhe besoj se ai vendim do të pezullohet deri në një vendim tjetër.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, kryetarja e Komisionit konstatoi se u nxor ky:

P e r f u n d i m

1. Vërejtjet t'i adresohen me shkrim Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie.

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete.

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me Rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete dhe tha se kjo është konsideruar si shkelje e të drejtave të njeriut nga Avokati i Popullit. Ne, si komision, nuk jemi kompetent për Ligjin për Automjete sepse është Komisioni për Zhvillim Ekonomik, prandaj do duhej që ta adresojmë zyrtarisht Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Hajdar Beqa tha se në bazë të informacioneve që kam, neni 43 po shqyrtohet nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik duke konsideruar që plotësisht ka të drejtë Avokati i Popullit sepse nuk janë të drejta kushtëzimet. Pra, në parim si deputet e mbështes edhe pse nuk është kompetencë e jona si komision. Ligji për Automjete është në plotësim ndryshim, pa këto nene dhe se Komisioni për Zhvillim Ekonomik është duke parë mundësinë, që të bëjnë amendament në lidhje me nenin 43 duke i konsideruar të drejta rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Korab Sejdiu tha se dalloj në mendim sepse edhe pse besoj që nuk jemi Komision Funkcional për këtë projektligj ne kemi kompetenca të shqyrtojmë nëse është në cenim të ndonjë dispozite Kushtetuese. Avokati i Popullit ka thënë se ajo çfarë po pretendohet me këtë ligj është cenim i të drejtës së pronës, prandaj ne jemi të obliguar të shqyrtojmë çdo ligj nëse është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe duhet ta kundërshtojmë në këtë aspekt. Po ashtu tha se çështja e kompensimit të paaftësive tona për t'i kryer punët tona, pastaj t'i kompensojmë ato me kushtëzime po krijon probleme të jashtëzakonshme për qytetaret e këtij vendi. Gjjobat eventuale nuk i jepen veturës, por personit dhe kushtëzimi i regjistrimit të veturës nuk ka të bëjë asgjë me gjjobë. Propozoi që si administratë publike të kemi një rishikim të kushtëzimeve të tilla dhe nëse është mundësia t'i eliminojmë në tërësi kushtëzimet e tilla, sepse në asnjë mënyrë nuk arsyetohet shkaktimi i problemeve për qytetarët tanë vetëm pse ne nuk duam të krijojmë mundësi për t'i kryer punët tona si administratë publike. Në fund tha se nëse ky ligj vjen te ne pa u eliminuar neni 43, paragrafin 2, këtë të rekomandojmë ne si komision që të fshihet sepse është antikushtetuese.

Hajdar Beqa tha se në bazë të informacioneve që kam Plotësim- Ndryshimi i ligjit për Automjete nuk e parashih nënin 43, duke pohuar se i kam sugjeruar kryetares së Komisionit për Zhvillim Ekonomik që të shikojnë mundësinë ligjore për të bërë një amendament për nenin 43. Më tej z. Beqa propozoi që nëse komisioni përkatës nuk e ka bërë amendamentin në lidhje me nenin 43 të Ligjit për Automjete, atëherë të shohim mundësinë, që ne, si komision, të bëjmë amendament sepse kushtëzimet nuk janë të drejta.

Pas diskutimeve nga anëtarët e Komisionit u dakorduan që të bisedojnë me kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, për të parë veprimet, që ata kanë ndërmarrë në mënyrë që të mos ndërmarrim veprime paralele.

5. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin e Komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe tha se vetëm Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pasur vërejtje të Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ku thotë se duhet të shtohet një amendament në nenin 17, paragrafi 1. Po ashtu tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Gjykata nr. 06/L-054 ende nuk kanë dhënë rekomandim, por ka kaluar afati dhjetë ditë dhe ne ia procedojmë seancës.

Kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri e procedoi për Kuvend Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës me rekomandim e propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si vijon:

Amendamenti 1

Neni 17, paragrafi 1, ndryshohet me tekstin si vijon:

1. Këshilli harton buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

6. Të ndryshme

A. Propozimi që të caktohet një anëtar nga Komisioni për Legjislacion në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit për ish- të dënuarve dhe të ish- të përndjekurve politikë

Kryetarja tha se ata më kanë kërkuar që ta procedojmë sa më shpejt emrin sepse nuk mund të funksionojnë pa një anëtar të Komisionit për Legjislacion. Më herët në këtë Komision ka qenë z. Bilall Sherifi, andaj propozoi z. Sami Kurteshi për të qenë në këtë komision.

Hajdar Beqa tha se të dy e meritojnë për të qenë anëtar të këtij komisioni, por propozoi që të jetë sërish z. Bilall Sherifi.

Bilall Sherifi tha se kam qenë një vit në këtë komision, por për shkak të obligimeve e ka të pamundur për të qenë në këtë komision.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se Komisioni një zëri mori këtë:

V e n d i m

Deputeti Sami Kurteshi caktohet anëtar në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të dënuarve dhe të ish- të përndjekurve politikë.

B. Njoftim

Kryetarja njoftoi se më 31.10.2018 znj. Nataliya Apostolova ka kërkuar takim me Komisionin për Legjislacion, ku temë e takimit do të jetë Projektligjet që janë në proces shqyrtimi në komisionin tonë. Takimi do të mbahet në sallën C-301 dhe do të nisë në orën 8 e 30 minuta.

Hajdar Beqa kërkoi që të shpejtojmë me projektligjet të cilat janë në komision.

C. Njoftim

Sami Kurteshi tha se së bashku me z. Shkumbin Demaliaj jemi të deleguar nga komisioni që të marrim pjesë në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në lidhje me Projektligjin për Pagat dhe Zyrtarët Publikë. Dëgjimi publik është mbajtur sot sipas ftesës që është dërguar, por dëgjimi publik ishte për palët e treta, për grupet e interesit dhe nuk ishte për deputetët.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu